



A.nr. 428/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.428/2026, të datës 14.04.2026, të parashtruar nga ankuesi R.P, nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit/Inspektoratit Qendror të Punës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 20.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.428/2026, e datës 14.04.2026, e parashtruar nga ankuesi R.P.

A r s y e t i m

Ankuesi R.P (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 11.04.2025, përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 14.04.2026 nën shenjën A.nr.428/2026, ndaj mos zbatimit të vendimit administrativ, mos kompensimit të drejtave nga marrëdhënie e punës dhe shkelje të procedurës standarde administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.04.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Inspektorati Qendror të Punës, ndërsa, ky i fundit më datë 29.04.2026, ka përcjell dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:Ankesën me numër protokolli 1935/2026, të datës 14.04.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 139 të datës 27.01.2026; Kopjen e ID-së së ankuesit; Plotësimin e ankesës datës 16.04.2026; Kërkesë për aprovim të panit i datës 06.02.2026 nga ankuesi; Emailin e datës 10.02.2026 nga ankuesi për V.Zh; Emailin e datës 20.01.2026 nga V.K për ankuesin; Emailin e datës 24.10.2025 nga ankuesi për V.K; Emailin e datës 09.02.2026 nga ankuesi për V.Zh; Emailin e datës 04.12.2025 dhe 03.12.2025 nga ankuesi për E.M; Emailin e datës 03.12.2025 nga E.M për ankuesin; Emailin e datës 31.03.2026 nga ankuesi për F.K; Emailin e datës 26.03.2026 nga F.K për ankuesin; Emailin e datës 26.03.2026 nga ankuesi për F.K; Emailin e datës 25.03.2025 nga F.K për ankuesin; Emailin e datës 10.04.2025 nga F.K për ankuesin; Emailin e datës 08.04.2025 nga ankuesi për F.K; Emailin e datës 23.03.2026 nga ankuesi për V.Zh; Emailin e datës 18.03.2026 nga Nj.M për ankuesin; Emailin e datës 12.03.2026, 11.03.2026, 10.03.2026 nga ankuesi për V.Zh; Emailin e datës 09.03.2026 nga V.Zh për A.D, T.K, L.M, M.C, A.O, A.R, B.F, S.K; Emailin e datës 10.03.2026 nga F.M për ankuesin; Emailin e datës 09.03.2025, 05.03.2026, 02.03.2026, 27.02.2026, 26.02.2026, 23.02.2026, 20.02.2026, 16.02.2026,

11.02.2026, 10.02.2026 nga ankuesi për V.Zh; Dëshmi për pagën e muajit mars dhe shkurt të vitit 2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.04.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 29.04.2026; Akt Emërimit të datës 24.09.2025 të ankuesit; Kërkesën për pëlqim për transferim të përhershëm e datës 03.03.2026 nga ankuesi; Vendimin me numër protokoll 466 të datës 06.03.2026 për transferimin e ankuesit; Vendimin me numër protokoll 497 të datës 12.03.2026 për shfuqizimin e vendimit nr. 139 të datës 27.01.2026.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës , ka konstatuar se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, del se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 24.09.2025, mban pozitën Zyrtar i Lartë Shpenzues dhe i Pasurisë në Inspektoratin Qendror të Punës, ndërsa sipas Vendimit me numër protokoll 139 të datës 27.01.2026 të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit për Cilësi të Inspektimeve.

Tutje përmes provave të lëndës, më datë 03.03.2026, ankuesi ka dhënë pëlqimin për transferim të përhershëm në pozitën Zyrtar i Lartë për Cilësi të Inspektimeve, kurse sipas Vendimit me numër protokoll 466 të datës 06.03.2026, të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, ankuesi është transferuar në mënyrë të përkohshme në pozitën Zyrtar i Lartë për Cilësi të Inspektimeve.

Më datë 12.03.2026, ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, ka nxjerr Vendimin me numër protokoll 497 , me të cilin plotësohet Vendimi nr. 466 i datës 06.03.2026, me këtë vendim, duke shtuar këtë pikë: *Me hyrjen në fuqi të vendimit Nr. 466 të datës 06.03.2026 shfuqizohet vendimi me Nr. 139 i datës 27.01.2026.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se përkundër se nga data 27.01.2026 deri më datë 06.03.2026, sipas vendimit me numër protokoll 139 ka mbajtur pozitën e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit për Cilësi të Inspektimeve, ndërsa me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.466 për transferim nuk është shfuqizuar vendimi paraprak pra vendimi për ushtrues detyre. Edhe përkundër që kam ushtruar detyrën sipas vendimit me numër 139, për periudhën janar-mars 2026 nuk jam paguar sipas pagës së pozitës që kam ushtruar, pagën e trembëdhjetë në bazë të të ardhurave vjetore. Kërkon që të konstatohet se Vendimi me nr.139 i datës 27.01.2026 ka qenë dhe mbetet i ligjshëm, të konstatohet se njoftimi i datës 26.03.2026 nuk përbën akt administrativ, të obligoj Inspektoratin Qendror të Punës të nxjerr vendim formal për shfuqizimin e vendimit me Nr.139, të obligoj Inspektoratin e Punës të kompensoj menjëherë pagën e plotë për muajin Janar, Shkurt dhe Mars 2026 sipas vendimit me nr.139, pagën e trembëdhjetë proporcionale dhe çdo shtesë apo kompensim tjetër që rrjedh nga pozita sipas vendimit nr. 139.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore të ankuesit dhe provave materiale të lëndës, fillimisht konstaton se përmes Vendimit me numër protokoll 139 të datës 27.01.2026 të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, ankuesi është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit për Cilësi të Inspektimeve, por që ndaj këtij vendimi me datë 29.01.2026, është parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga nëpunësi civil gjegjësisht Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Inspektoratit të Punës, me pretendimet se me rastin e caktimit të ankuesit ushtrues detyre në pozitën Drejtor i Departamentit për Cilësi të Inspektimeve është shkelur neni 35 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, sepse ushtruesi i detyrës caktohet nga kategoria pasuese. Rrjedhimisht duke qenë se ndaj Vendimit me numër protokoll 139 të datës 27.01.2026 të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës është parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën, në këtë rast duke marr parasysh faktin se Vendimi me numër protokoll 139 i datës 27.01.2026, ka përmbajtur*

këshillën juridike, atëherë i njëjti nuk ka mund të bëhet i ekzekutueshëm pa u plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa lidhur me pezullimin e aktit administrativ ndaj të cilit është parashtruar ankesë që ndërlihet me Vendimin me numër protokollit 139 të datës 27.01.2026, Inspektorati Qendror i Punës është njoftuar përmes kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 04.02.2026.

Pra nga konstatimi si më sipër, Kolegji i Këshillit, sjell në vëmendje se Vendimi me numër protokollit 139 i datës 27.01.2026, i ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës për caktimin e ankuesit Drejtor të Departamentit për Cilësi të Inspektiveve, ligjërisht nuk ka mund të zbatohet përderisa ndaj tij është ushtruar ankesë dhe për rrjedhojë nuk ka mundur të prodhojë asnjë pasojë juridike, por përkundër kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi i cili sipas Vendimit me numër protokollit 139 të datës 27.01.2026, është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit për Cilësi të Inspektiveve, si pozitë parësore kishte atë sipas Akt Emërimit të datës 24.09.2025, pra pozitën Zyrtar i Lartë Shpenzues dhe i Pasurisë, e që sipas nenit 35 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin përcaktohet se: *“1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit..”* si dhe nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: *“1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari...”*, dhe si rrjedhojë duke u bazuar në këtë bazë ligjore, Kolegji konstaton se ankuesi sipas dispozitave ligjore në fuqi nuk mund të caktohej ushtrues detyre në pozitën Drejtor i Departamentit për Cilësi të Inspektiveve (si pozitë e kategorisë së mesme drejtuese), kur i njëjti pozitën parësore me akt emërimi e kishte të kategorisë profesionale, ndërsa sipas strukturës organizative të Inspektoratit Qendror të Punës, ka pasur nëpunës civil që kanë mbajtur pozita të kategorisë pasuese në vartësi të pozitës së Drejtorit të Departamentit për Cilësi të Inspektiveve, kështu që Inspektorati i Qendror i Punës, ka qenë plotësisht i njoftuar sipas Vendimit A.nr.1390/2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që ushtruesi i detyrës duhet të caktohet zyrtari më i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, pra nuk qëndron pretendimi i ankuesit se Vendimi me numër protokollit 139 i datës 27.01.2026 konsiderohet i ligjshëm.

Kolegji i Këshillit, nga provat e lëndës, tutje ka konstatuar se sipas Vendimit me numër protokollit 466 të datës 06.03.2026, të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, ankuesi është transferuar në mënyrë të përkohshme në pozitën Zyrtar i Lartë për Cilësi të Inspektiveve dhe sipas këtij vendimi është përcaktuar që i njëjti hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit, ndërsa më datë 12.03.2026, ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, ka nxjerr Vendim me numër protokollit 497, me të cilin plotësohet Vendimi me nr. 466 i datës 06.03.2026, duke shtuar këtë pikë: Me hyrjen në fuqi të vendimit Nr. 466 të datës 06.03.2026 shfuqizohet vendimi me Nr.139 i datës 27.01.2026, pra siç mund të shihet qartazi nga provat e lëndës, Vendimi me numër protokollit 139 i datës 27.01.2026, i ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, për caktimin e ankuesit ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit për Cilësi të Inspektiveve është shfuqizuar sipas Vendimit me numër protokollit 497 të datës 12.03.2026, pra nuk qëndron aspak pretendimi i ankuesit se Vendimi me numër protokollit 139 i datës 27.01.2026 nuk është shfuqizuar.

Pra nga konstatimet si më sipër, si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit që të ju njihen të drejtat sipas Vendimit me nr.139 i datës 27.01.2026 për caktimin e tij ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit për Cilësi të Inspektiveve, pra paga mujore për muajin janar, shkurt dhe mars 2026, paga e trembëdhjetë proporcionale dhe çdo shtesë apo kompensim tjetër që rrjedh nga pozita sipas vendimit nr. 139, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të paqëndrueshme, sepse

ankuesi nuk mund të përfitoj asnjë të drejtë nga një vendim që ndaj të cilit është parashtruar ankesë te organi më i lartë administrativ në këtë rast te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse në rastin konkret ankesa i ka pezulluar në mënyrë automatike të gjitha efektet e aktit të kontestuar pra Vendimit me nr.139 i datës 27.01.2026, e për rrjedhojë ankuesi pagën për muajin shkurt dhe mars të vitit 2026 e ka përfituar sipas koeficientit të pozitës që ka pasur sipas aktit të emërimit e në këtë rast edhe pagën e trembëdhjetë (13) e ka përfituar sipas pozitës që ka mbajtur me akt emërim, dhe mbi këto konstatime Kolegji i Këshillit, vlerëson se në raport me ankuesin nuk ka pasur asnjë cenim i të drejtëve të tij, sepse nuk mund të përfitohen të drejtat nga një vendim që përveç që nuk ka mundur të zbatohet për shkak të efektit pezullues të ankesës, i njëjti ka qenë i nxjerr në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe për këtë institucioni ka qenë në dijeni, andaj sipas konstatimeve si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuar dhe nuk gjejnë mbështetje ligjore.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.428/2026, datë 20/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit R.P;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.